



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, date 10 / 07 /2026

“PËR MIRATIM RISHPERNDARJE FONDESH NDERMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E

BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“, neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë , te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit perfundimtar perfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026” si dhe materialeve te sjelle nga stafi i projektit me financim te perbashket me fondet e BE “Rivitalizimi i Qendres Komunitare Kurjan”, materialeve te sjell nga drejtorite perkatese ;

- Ju paraqesim për diskutim e miratim;

- I. Të miratohet rishperndarja e fondeve ndermjet programeve per objektet e investime dhe shpenzimeve per operative & mirembajtje ne buxhetin e vitit 2026 si me poshte vijone:

Shtohet:

N R	G R	TIT	K A P	A R T	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe shtohet	2026	2027	2028
1	00	4520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Shtese fondi per objektin : Mbikqyje dhe kolaudim objekti	Bashkia Roskovec	3,000,000	3,000,000	0	0
2	00	8220	1 5	231	Trashegimia kulturore , monomentet, muzete dhe bibliotekat	Objekti “Ndertimi I bibliotekes se re te qytetit Roskovec	Bashkia Roskovec	42,522,434	1,191,241 1,565,489	28,889,508	10,876,196

3	00	4520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Vendosja e semaforit ne qender te Roskovecit	Bashkia Roskovec	9,997,607	2,999,282	6,998,325	
4	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Blerje Asfalti	Bashkia Roskovec	1,500,000	1,500,000	0	0
5	00	06370	5	230	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	Hartim projekti ujesjellesi ne fshatin Ngjeqar	Bashkia Roskovec	3,000,000	1,000,000	2,000,000	
6	00	04240	5	600 +601	Menaxhim I ujitjes dhe kullimit	Paga dhe sigurime per sektorin e vaditjes	Ndermarrja e sherbimeve komunale	2,400,000	2,400,000	0	0
7	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Blerje cakull, stabilizante dhe rere bituminoze	Bashkia Roskovec	2,800,000	2,800,000	0	0
8	00	09120	1	602	Arsimi baze (parashkollore)	Blerje material per riparime te pjeshme te shkolla	Bashkia Roskovec	1,980,000	1,980,000		
					SHUMA:			67,200,041	18,436,012	37,887,833	10,876,196

Pakesohet:

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2026	2027
1.	00	04520	5	231	Rrjeti Rrugor Rural	Blerje Asfalti	Bashkia Roskovec	150,000	150,000	0
2.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	"Riveshje me stresa asfaltike ne rruget e Njesis Administrative Kurjan"	Bashkia Roskovec	9,246,070	0	9,246,070
3.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	"Riveshje me shtresa asfaltike ne rrugicat e lagjes Nr. 1, L=1602 ml, Roskovec"	Bashkia Roskovec	6,851,024	0	6,851,024
4.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	"Riveshje me stresa asfaltike ne rruget e Njesis Administrative Kuman"	Bashkia Roskovec	8,511,778	0	8,511,778

5.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Riveshje me stresa asfaltike në rrugët e Njësise Administrative Strum"	Bashkia Roskovec	6,985,998	0	6,985,998
6.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Ndertim biblioteke ne qytetin Roskovec	Bashkia Roskovec	7,466,400	7,466,400	0
7.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Sinjalistika rrugore e rruges Todi Pipa,Marinez	Bashkia Roskovec	300,000	300,000	0
8.	00	04240	1	231	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	Bashkefinancim per projektin vendosja e paneleve diellore prane stacionit te pompimit	Bashkia Roskovec	1,000,000	1,000,000	0
9.	00	04520	1	231	Rrjeti Rrugor Rural	Sistemim I Ambienteve te poligonit,Roskovec	Bashkia Roskovec	6,132,086	1,839,123	4,292,963
10.	00	08220	05	230	Trashegimia kulturore , monomentet,muzet e dhe bibliotekat	"Hartim projekti për bibliotekën"	Bashkia Roskovec	516,000	516,000	0
11.	00	10430	05	602	Kujdesi social per femijet dhe familjet	"Mallra ushqimore për çerdhen"	Bashkia Roskovec	434,400	434,400	0
12.	00	04220	05	230	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëveit	Hartim studim fizibiliteti	Bashkia Roskovec	350,000	350,000	0
13.	00	01110	05	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi Vendore	"Shërbim dhe blerje për mirëmbajtjen e rrjetit të pajisjeve kompjuterike dhe sistemit të kamerave"	Bashkia Roskovec	144,800	144,800	0
14.	00	09120	05	602	Arsimi baze (parashkollor	"Kolaudim kaldaje dhe çertifikim personeli"	Bashkia Roskovec	199,999	199,999	0
15.	00	09120	01	602	Arsimi baze (parashkollor	Kolaudim instalime elektrike	Bashkia Roskovec	885,000	885,000	0

16.	00	04240	1	231	Menaxhim I ujitjes dhe kullimit	Makineri dhe pajisje	Ndermarra e sherbimeve komunale	1,980,000	1,980,000	0
17.	00	09120	5	231	Arsimi baze (parashkollor	Riparimi I shkolles ne fshatin Arapaj	Bashkia Roskovec	3,883,344	1,883,344	2,000,000
18.	00	01110	5	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi Vendore	Shpenzime per organizimin e seances plenare ARLEM-it	Bashkia Roskovec	1,286,946	1,286,946	0
						SHUMA:		56,323,845	18,436,012	37,887,833

II. - Bazuar ne kerkesen dhe relacionin e derguar nga stafi i projektit me financim te huaj

“Rivitalizimi i Qendres Komunitare Kurjan”, sektori I Integrimit European, si dhe te mareveshjes se Grantit nr. 2022/434-568 me Komisionin Evropian , kerkojme rishperndarja e fondeve te pasfinansimit te projektit me vlerë **3,537,000 lekë** ndermjet programeve per shpenzimet operative & mirembajtje ne buxhetin e vitit 2026 si me poshte vijone:

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT / SHPENZIMIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit / shpenzimit qe shtohet	2026	2027
1.	00	01110	02	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi Vendore	Mbeshtetja e start-up-eve te reja	Bashkia Roskovec	1,000,000	1,000,000	0
2.	00	01110	02	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi Vendore	Aktivitet dhe iniciativa mbi ceshtjet e barazise gjinore	Bashkia Roskovec	500,000	500,000	0
3.	00	01110	02	602	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi Vendore	Partneritet dhe anetaresime te reja ne programe dhe platform nderkombetare	Bashkia Roskovec	2,037,000	2,037,000	0
					SHUMA:			3,537,000	3,537,000	0

III. Ngarkohet Administrata e Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.

Konceptoi: O.Goga

Konfirmoi: D.Hoxha

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo

KRYETAR
Majlinda BUFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 5255/1 Prot.
Dt. 10.07.2026

Lenda: Relacion per Projekt-Vendimin “Për miratim rishperndarje fondesh ndermjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026”

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Të nderuar anëtar/anëtare te KB !

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“,neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë , te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit perfundimtar perfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026” si dhe materialeve te sjelle nga stafi i projektit me financim te perbashket me fondet e BE“Rivitalizimi i Qendres Komunitare Kurjan”,materialeve te sjell nga drejtorite perkatese ;

Ju relatojme:

Në këtë projekt-vendim kemi përcaktuar përdorim të fondeve të ngelura nga prokurimet e zhvilluara për objektet e investimeve të planifikuara për vitin buxhetor 2026.

Mendojmë përdorimin e fondeve si më sipër në dy objekte të reja për investime ,një shtesë në zërin mbikqyrje dhe kolaudim,zëri blerje rërë,stabilizante cakull dhe asfalt dhe nje zë i ri te shpenzimeve page dhe sigurime . Sipas projekt-vendimit bashkëlidhur bazuar në kërkesat e argumentuara nga drejtoritë të cilat janë të domosdoshme dhe që nevoja për alokimin e këtyre fondeve ka dalë gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2026, dhe me konkretisht:

1. Shtesë fondi për objektin : Mbikqyrje dhe kolaudim objekteve të reja, fond i cili është përlllogaritur nga shtimi i 2 objekteve të reja të investimeve (Ndërtim Bibliotekë e Re në qytetin Roskovec dhe Ndërtimi i semaforit) . Fondi prej 3,000,000 lekë do i shtohet fondit të miratuar për këtë qëllim në buxhetin fillestar të bashkisë për vitin 2026.
2. Investime për objekte : “Ndërtimi I bibliotekes së re të qytetit Roskovec dhe Ndërtimi i semaforit në qendër të qytetit” Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës publike, rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban të Bashkisë Roskovec, dy projekte

të përfshira në listën e projekteve prioritare dhe me rëndësi të veçantë për komunitetin janë “Biblioteka Publike e Roskovecit” dhe “Vendosja e semaforit në qendër të Roskovecit. Nevoja për këtë fond ka rrjedhur si pasojë e projekteve të objekteve për investime dhe që mendohet të financohen në vitin 2026 e më tej , për një planifikim sa me real dhe të plotë të investimeve në buxhetet e këtyre viteve.

-Vlera e përlogaritur e **“Ndërtimi i bibliotekës së re të qytetit Roskovec”** është në masën **42,522,434** lekë.

Ky projekt parashikon ndërtimin e një biblioteke publike bashkëkohore, e konceptuar si një qendër multifunksionale kulturore, edukative dhe sociale në shërbim të komunitetit lokal. Objekti do të ndërtohet në qytetin e Roskovecit, në një zonë me akses të përshtatshëm urban dhe me lidhje të mirë me institucionet arsimore dhe kulturore. Sipërfaqja totale e godinës është rreth 365 m², e organizuar në një pjesë njëkatëshe dhe një pjesë dykatëshe, me holl hyrës dy kate që shërben si element orientues dhe përfaqësues I objektit.

-Vlera e përlogaritur e **“Ndërtimi i semaforit në qendër të qytetit”** është në masën e **9,997,607** lekë.

Ky projekt synon përmirësimin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin më efikas të qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve në një nga nyjet më të rëndësishme të qytetit. Ndërhyrjapërfshin:

- Punime civile për ndërtimin dhe përshtatjen e nyjës me semafor;
- Punime instalatore dhe elektromekanike për vendosjen dhe funksionalizimin e sistemit të semaforëve;
- Integrimin e sinjalistikës përkatëse rrugore dhe elementeve të sigurisë.

3.Hartim projekti teknik për ndërtimin e një sistemi të ri ujësjellësi me vlerë 3,000,000 leke

Bazuar në kërkesat e vazhdueshme dhe rëndësisë së problematikës, deri më sot nuk është realizuar një investim për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe fshati vijon të mbetet pa furnizim me ujë të pijshëm.

Zgjidhja e kësaj situatë kërkon ndërtimin e një sistemi të ri ujësjellësi. Për realizimin e investimit është e domosdoshme që paraprakisht të hartohet projekti teknik, i cili do të përcaktojë zgjidhjen e përshtatshme për furnizimin me ujë të pijshëm, burimin e furnizimit, gjurmën dhe dimensionimin e rrjetit, veprat e nevojshme, preventivin dhe vlerën e investimit.

Hartimi i projektit përbën hapin e parë të domosdoshëm për përcaktimin e zgjidhjes teknike, vlerës së investimit dhe krijimin e mundësisë për sigurimin e financimit të nevojshëm për ndërtimin e ujësjellësit.

Gjithashtu ju paraqesim , bazuar në kërkesat e Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale përkatëse të bashkëlidhur , dhe miratimin e fondeve për zërat blerje rërë bituminoze, stabilizante, cakull dhe asfalt për dy zëra të reja investimesh dhe konkretisht:

1. Blerje Asfalt , fond i cili është shume i domosdoshëm sipas kërkesë së Ndërmarrjes për ndërhyrje në riparime të ndryshme të rrugëve. Vlera e llogaritur për këtë zë shpenzimesh është në masën 1,500,000 lekë.
2. Blerje Cakull,Stabilizantë dhe Rërë bituminoze , fond i cili është shumë i domosdoshëm sipas kërkesës së Ndërmarrjes për ndërhyrje me riparime të ndryshme të rrugëve. Vlera e llogaritur për këtë zë shpenzimesh është në masën 2,800,000 lekë.
3. Blerje materiale per riparime te pjeshme te shkollave fond i cili është shumë i domosdoshëm sipas kërkesës së Ndërmarrjes për ndërhyrje me riparime të ndryshme ne shkolla. Vlera e llogaritur për këtë zë shpenzimesh është në masën 1,980,000 lekë.

4.Bazuar në kërkesën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale për shtesë të numrit të punonjësve dhe krijimin e një strukture të posacme në drejtorinë e Zhvillimit Rural dhe shërbimeve kemi planifikimin si më poshtë:

1.Paga dhe sigurime në vlerën 2,400,000 lekë.

II. Në kuadër të alokimit të fondit si pasfinancim i projektit“Rivitalizimi i Shkollës Qendër Komunitare në Kurjan për një qasje më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet në nevojë”, i zbatuar në përputhje me politikat dhe standardet e Bashkimit Evropian për zhvillim lokal dhe përfshirje sociale, kërkojmë mirëkuptimin tuaj, në përdorimin e fondit prej **3,537,000** për aktivitetet e mëposhtme:

1. Partneritete dhe anëtarësime të reja në programe dhe platforma ndërkombëtare në vlerë 2,037,000 lekë.

Ky komponent synon forcimin e kapaciteteve institucionale të Bashkisë Roskovec përmes anëtarësimit në rrjete, platforma dhe programe ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin social, ekonomik dhe rinor, si dhe rritjen e aksesit në bashkëpunime dhe fonde ndërkombëtare.

2. Mbështetja e start-up-eve të reja ne vleren 1,000,000 lekë.

Synon mxitjen e sipërmarrjes rinore dhe inovacionit në nivel lokal, përmes mbështetjes së iniciativave të reja biznesi (start-up-e), mentorimit, shkëmbimit të praktikave të mira dhe krijimit të mundësive për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në komunitet.

3. Aktivitet dhe iniciativa mbi çështjet e barazisë gjinore në vlerën 500,000 lekë.

Ky komponent synon organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere, forumeve, trajnimeve dhe iniciativave lokale që promovojnë barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit.

Argumentimi i nevojës

Në kuadër të alokimit të një fondi si pasfinancim i projektit të sipërcituar, vlerësohet e domosdoshme realizimi i një sërë aktivitetesh mbështetëse që garantojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të projektit.

Këto aktivitete nuk përbëjnë ndërhyrje të izoluara, por janë pjesë integrale e logjikës së projektit dhe shërbejnë për të siguruar vazhdimësinë, konsolidimin dhe zgjerimin e impaktit afatgjatë të tij në komunitet. Në veçanti, ato kontribuojnë në transformimin e rezultateve të projektit nga ndërhyrje afatshkurtra në politika dhe praktika të qëndrueshme zhvillimore në nivel vendor.

Komponentët e parashikuar lidhen drejtpërdrejt me objektivat strategjike të projektit dhe me prioritetet e Bashkimit Evropian në fushat e zhvillimit social, inovacionit, përfshirjes ekonomike dhe barazisë gjinore. Përmes tyre synohet forcimi i qëndrueshmërisë institucionale të rezultateve, rritja e ndikimit afatgjatë të investimeve të realizuara dhe krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm bashkëpunimi me rrjete dhe platforma ndërkombëtare.

Në përfundim kjo ndërhyrje kontribuon në rritjen e besueshmërisë institucionale të Bashkisë Roskovec përballë donatorëve ndërkombëtarë, duke dëshmuar kapacitetin për menaxhim efektiv të fondeve, përmbushje të objektivave të projekteve dhe zhvillim të partneriteteve afatgjata në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Për këtë arsyeje do të jemi të detyruar që të bëjmë dhe ndryshimet përkatëse në PBA 2027-2029 , për pjesën e të pritshmit të vitit 2026 meqë janë dhe transferime ndërmjet programeve dhe që këto fonde ishin miratuar në buxhetin fillestar me financim për vitin 2026 , afati përfundimtar i të cilave është data 15 shtator 2026 , datë në të cilin dërgohet në Ministrinë e Financave dhe PBA e rishikuar.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e Projekt-Vendimit “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

Konc: O.Goga

Miratoi: D.Hoxha

KRYETAR
Majlinda Buqi